



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality Assambly
Hani i Elezit



01/Nr. 9965/2022
Data : 06.12.2022

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e njëmbëdhjetë -XI- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe financa , mbajtur me datë 15.11.2022 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkyetari i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Liridona Ballazhi** (Shefe në Kabinetin e Kryetarit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesi i OSB-së.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.
3. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rendit të punës të cilat janë përcjell kemi edhe një pikë shtesë Raporti i vlerësimit të përgjithshëm për prona rezidenciale Komuna Hani i Elezit. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- është mirë që me na i dërguar material me kohë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim pikën shtesë; rezultati i votimit ishte një zëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.**
- 3. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.**
- 4. Raporti i vlerësimit të përgjithshëm për prona rezidenciale Komuna Hani i Elezit.**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Abduraman Bushi thekson:- përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sherif Berisha thekson:-si ka shkuar procedura e subvencionimit të fermerëve dhe pjesës tjetër që është subvencionuar. A do të subvencionohen fermerët të cilët kanë mbjellur grurë në këtë vit.

Abduraman Bushi thekson:- janë subvencionuar fermerët të cilët nuk kanë mundur me i përbushur kriteret për me marr subvencione prej Ministrisë së Bujqësisë. Fermerët të cilët i kanë të mbjellur grurë nën dy hektarë subvencionohen nga komuna. Nga viti i ardhshëm duhet ta ndërrojmë formën e subvencionimit për fermerët të cilët nuk i kanë nga dy hektarë që me i bashkuar parcelat dhe me u subvencionuar nga Ministria ndërsa në vjeshtë me pasur mundësi që me i subvencionuar komuna. Në këtë vit nuk kemi drejtë me i subvencionuar dy herë .

Kryesuesi thekson:- është mirë që ta kemi listën e përfituesve prej OJQ Labi në mënyrë që drejtoria me qenë e informuar se kush përfiton prej OJQ Labi.

Abduraman Bushi thekson:- te OJQ Labi isha pjesë e komisioni dhe nuk ju kamë përzier tyre për shkak se ata i kanë politikat e veta të cilat i zhvillojnë. Listën e kam sjell te komuna dhe i kanë subvencionuar tri skema

Kryesuesi thekson:- OJQ Labi nuk është mirë me subvencionuar dikend pa pëlqimin tënd për shkak se OJQ Labi është krijuar në emër të komunitetit dhe duhet të jeni në dioni për çdo send e jo me ardhur prej Prishtinës dhe me përfituar në Han të Elezit për shkak se ka marrëveshje me ndihmuar komunitetin.

Abduraman Bushi thekson:- skemat tjera janë skema ekonomike dhe më ftojnë që të jem prezent por nuk janë skema bujqësore.

Sherif Berisha thekson:- marrëveshjen është mirë që ta kemi edhe ne. Përveç juve si drejtor a është në komision edhe dikush tjetër prej komunës. Komuna duhet të jetë më e zëshme ndaj OJQ. Labi për çështje të subvacioneve .

Abduraman Bushi thekson:- subvencionet të cilat janë ndarë në këtë vit përfitues janë të gjithë të komunës së Hanit të Elezit

Majlinda Kaloshi thekson:- ne nuk kemi të drejtë me ndikuar se kush me qenë përfitues në subvacione për shkak se është OJQ.

Kryesuesi thekson:- është e vërtetë që është OJQ por është themeluar për me ndihmuar komunitetin e Hanit të Elezit për shkak dëmit të cilin e shkakton në komunitet dhe nuk guxon me i dhënë dikujt subvencion jashtë Hanit të Elezit .

Refet Kalisi thekson:- sipas informatave që kam OJQ. Labi është formuar për me i ndihmuar Hanit të Elezit për shkak të dëmit të cilin ja shkakton dhe nuk mundem me kuptuar që me përfituar dikush nga Prishtina në OJQ. Labi që ndoshta ligjërisht ka të drejtë , mirëpo me përfituar edhe të tjerë në Han të Elezit mendoj që nuk është në rregull. Fermerët e rinj të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet dhe janë duke i mbjell pronat , a ekziston mundësia për me ju ndihmuar .

Nora Xhoni thekson:- si është bërë subvencion i OJQ Mjalti.

Abduraman Bushi thekson:- nuk kemi të drejtë që një kulturë me subvencionuar dy herë brenda një viti. Është subvencionuar shoqata e bletarëve Mjalti në Han të Elezit dhe ata pastaj e kanë bërë shpërndarjen. Kam kërkuar që të ma sjellin një raport se si ka shkuar procedura e ndarjes.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË BUJQËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- materialin e kemi dërguar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a mund të na sqaroni për takimin të cilin e keni pasur me shoqatën “Islamik Relief” dhe për inspektimet e rrymës që i ka bërë kompania “Sharrcem ”

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- projektin e kam dorëzuar për nevojat për staf të cilat i kemi në QKMF por ata më kanë njofuar se është ndërruar bordi i kësaj shoqate dhe procedurat zgjatin deri në formimin e bordit të ri. Inxhinierët e kompanisë “Sharrcem ” e kanë kontrolluar gjendjen e rrymës në QKMF dhe ma kanë dërguar një raport për intervenimet që duhet të bëhen por për shkak mundësive buxhetore kanë mbetur për vitin e ardhshëm me i kryer.

Refet Kalisi thekson:- a i plotëson kushtet rryma për nxehjen që është vendosur.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- e kemi ftuar edhe inxhinierin të cilin ka rregulluar nxehjen që me parë se në çfarë gjendje është gjeneratori dhe a mundet me i mbuluar kapacitet që i ka ngrohja.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI GJENDJEN NË SHËNDETËSI QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4.Raporti i vlerësimit të përgjithshëm për prona rezidenciale Komuna Hani i Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- është raport të cilin ka dërguar departamenti i tatimit në pronë nga Ministria e financave. Nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- zonat të cilat janë ndarë nuk janë ndarë në mënyrën e duhur për shkak se qeverisja e kaluar nuk ka bashkëpunuar me zyrtarët e qeverisë dhe ata kanë vendosur vetë siç kanë menduar .

Refet Kalisi thekson:- komisioni ka dal në teren dhe i ka pyetur qytetarët e ja ka caktuar vlerën dhe nuk e di a kemi pasur mundësi me intervenuar si komunë

Kryesuesi thekson:- sipas informacioneve që kam përfaqësuesit nga ministria nuk kanë pasur bashkëpunim me qeverisjen e kaluar pra me zyrtarët e komunës për shkak se i kanë pyetur qytetarët dhe qytetarët për interesa të tyre kanë deklaruar për vlerën që e ka prona të cilën e posedon. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I VLERËSIMIT TË PËRGJITHSHËM PËR PRONA REZIDENCIALE KOMUNA E HANIT I ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Të ndryshme

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Sherfi Berisha thekson:- sipas mundësive të cilat i ka komuna si opozitë kërkojmë që ta kemi një zyre në objektin e komunës. Pse është vonuar proceduar për familjet e dëshmorëve për shkuarje në bajë. Sa ishte kostoja e vizitës të cilën ishin në Shqipëri me kompaninë “Sharrcem” dhe tema e diskutimit që ka qenë atje. Më intereson të dijë kostoja për hajkingun që është organizuar. Është një komision i kuvendit që ka pasur takim me përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” por mos ka edhe përfaqësues të tjerë që mbajnë takime. Kërkoj sqarim prej drejtoreshës së financave për një drekë që e ka pasur dhe ka pasur edhe persona privat. Në listë të pagave ka persona të cilët nuk janë në marrëdhënie pune por marrin pagë .

Lindita Ballazhi thekson:-është mirë që ta specifikoni se për cilën bëhet fjalë dhe është mirë ta tregoni edhe datën në mënyrë që ta dimë se në cilin tre mujorë të shpenzimeve. Ndryshimet për te lista e pagave i kemi përcjell por ndonjë herë nuk i ekzekutojnë me një herë për shkak se kemi pasur raste. Ju njoftojë se listat e pagave janë konfidenciale.

Majlinda Kaloshi thekson:- në trajnim kanë marr pjesë njëzet e katër persona dhe tema ka qenë përlider ship dhe përmenaxhim të situatave . Trajnim i është financuar nga kompania “Sharrcem”.

Kryesuesi thekson:- éshtë mirë të dihet edhe kostoja e trajnimit sepse kompania mund të shënon se ka kushtuar një kosto bukur të lartë dhe e llogaritë që për komunitet. Éshtë mirë të dihet shuma për shkak se e kemi bordin për komunitet dhe kompania “Sharrcem” mund të potencon që jam në rregull me komunitet dhe i kam shpenzuar këto mjete financiare.

Majlinda Kaloshi thekson:- nuk kemi informacione për çmimin se sa ka kushtuar por ka qenë numri prej njëzet e katër personave që kanë qenë dhe ja kthyer pa asnje detaj të keq éshtë sukses dhe i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit të cilët kanë qenë korrekt.

Kimete Kuka - Hasallari thekson:- për çështjen e shkuarjes në bajë kam pasur takim me familjet e dëshmorëve dhe janë kryer procedurat, mirëpo mënyra se pse janë vonuar deri më tani janë për shkak se viteve të më hershme kanë shkuar me një marrëveshje që e ka lidhur drejtoresha e shëndetësisë direkt me bajën dhe familjet e dëshmorëve kanë shkuar kur kanë dashur por auditori e ka gjetur shkelje dhe ka sugjeruar që mos me shkuar në atë mënyrë por përmes procedurave të prokurimit në mënyrë që me pasur mundësi me konkurruar edhe bajat e tjera e jo vetëm njëra. Procedurat kanë filluar që nga fillimi i gushtit dhe herën e parë nuk ka aplikuar askush, herën e dytë kanë aplikuar dy agjensi të kontabilitetit të cilat nuk kanë pasur kritere për me i dërguar në bajë dhe ka dështuar por kanë bërë ankesë për këtë proceduar se pse nuk janë përfitues dhe komuna ka dalë fitues në këtë rast se ka pasur të drejtë, hera e tretë ka aplikuar një kompani dhe éshtë fituese por presim që me nënshkruar kontratën. Éshtë vonuar deri më tani për shkak se procedurat kanë marr kohë dhe ua kam shpjeguar të gjitha çështjet edhe familjeve të dëshmorëve.

Liridona Ballazhi thekson:- hajkingu ka qenë i financuar nga kompania “Sharrcem” dhe vetëm e kanë kërkuar përkrahjen tonë që me pasur një bashkëpunim për me bërë thirrje për pjesëmarrje.

Refet Kalisi thekson:- deri ku kanë mbërrri punimet për çështjen e ujit.

Sevdi Dernjani thekson:- problemi ka qenë për disa shtylla të betonit për me u marr pëlqimi KEDS-it. Takim kam pasur me drejtorin e KEDS-it dhe tash janë në proces po presim në ditët në vijim për me dal dhe me vendosur shtyllat .

Sherif Berisha thekson:- a keni pasur komision për vlerësimin e druve të cilët i kanë sjell.


Natyra Kalisi thekson:- raportin për pranimin e druve e nënshkruan menaxheri i kontratës dhe për administratë ka qenë gjithçka në rregull ndërsa për tjerat nuk kam informata.

Ibadete Kalisi thekson:- në mes të terminalit dhe rrugës te Lagjja Vlashi kanë kërkesë që me pre një dru i cili éshtë i lartë dhe paraqet rrezikshmëri.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të myllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:39 .

Procesmbajtësi

Aym Bushi


Kryesuesi i Komitetit

Horim Shkreta

